



Shkurt 2020

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Mars

Prill

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Shkurt 2020

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2020
Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: amanda.kojku@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Shkurt 2020 arriti në 109.5 për qind;*
- *Norma vjetore e inflacionit për muajin Shkurt 2020 ishte 1.2 për qind;*
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Shkurt 2020 ishte 111.94 lekë për dollarë dhe 122.13 lekë për euro;*
- *Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Shkurt 2020 shënuan kuotën 0.42 për qind për ato 12-mujore; 0.27 për qind për depozitat 6-mujore; 0.14 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.76 për qind për depozitat 1-mujore;*
- *Normat e interesit për huatë në lekë ishin 6.26 për qind për huatë 12-mujore dhe 6.78 për qind për ato 6-mujore;*
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.330.924 milionë lekë në muajin Shkurt, duke shënuar një rritje prej rreth 4.1 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;*
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të 2019-ës rezultoi me rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 73.0 milionë euro.*
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar - Shkurt 2020 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 3.7 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej 0.6 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Shkurt 2020, arritën në rreth 71.236 miliardë lekë ose afërsisht 100% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 67.504 miliardë lekë ose rreth 93% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*


Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Shkurt 2020 ishte +1.2%. Ndërsa një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +1.7%. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Shkurt 2020 shënoi rritje prej 0.4 përqind krahasuar me muajin paraardhës. Gjithashtu për muajin Janar 2020 dhe Dhjetor 2019 indeksi shënoi rritje prej 1.9 përqind dhe 0.8 përqind respektivisht, krahasuar me muajin parardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Shkurt 2019 shënoi rritje prej 0.6 përqind në krahasim me muajin paraardhës.

Krahasuar me muajin Shkurt 2019, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë” me 2.4%, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1.9%, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1.4%, “Transporti” me 1.2%, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0.8% secili etj.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” dhe “Shëndeti” u ulën me 0.7% secili, pasuar nga “Komunikimi” me 0.3%.



Ndryshimi mujor i indeksit është 0.4%.

Krahasuar me muajin Janar 2020, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 1.0%, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 0.6%, “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0.1% secili.

Nga ana tjetër çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Transporti” u ulën me 0.2% secili, pasuar nga grupi “Shëndeti” me 0.1%.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2019	1.9	1.7	1.1	1.4	1.5	1.3	1.5	1.5	1.3	1.3	1.4	1.2
2020	1.5	1.2										


Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Shkurt 2020, arriti në 122.13 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.04 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Shkurt, një euro u këmbye me 122.74 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Shkurt 2020 arriti në 111.94 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 1.71 përqind kundrejt muajit Janar 2020. Në fund të muajit Shkurt, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 111.38 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Shkurt të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 1.96 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 2.02 përqind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të riskut për ekonominë tonë.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një rritje mesatare rreth 0.92 dollarë/euro.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Shkurt 2020, normat e interesit të depozitave me afat 1 dhe 12 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.76 dhe 0.42 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 3 dhe 6 mujore që arritën kuotën 0.14 dhe 0.27 përqind përkatësisht.


Normat e interesit të depozitave 1, 3 dhe 6 mujore kanë shënuar rënie mujore prej 0.05, 0.26 dhe 0.21 pikë përqindje respektivisht, ndërsa normat e interesit të depozitave 12 mujore kanë shënuar rritje mujore me 0.02 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 3, 6 dhe 12 mujore, kanë pësuar rënie vjetore prej përkatësisht 0.11, 0.18 dhe 0.26 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 1 mujore kanë shënuar rritje vjetore me 0.05 pikë përqindje.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore gjatë muajit Shkurt 2020 arritën përkatësisht kuotën prej 6.78 dhe 6.26 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 6 dhe 12 mujore kanë pësuar rënie mujore prej 0.09 dhe 0.47 pikë përqindje përkatësisht. Duke e krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 mujore pësuan rënie vjetore me 0.72 pikë përqindje, ndërsa ato normat e interesit të huave 12 mujore shënuan rritje vjetore prej 0.37 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Shkurt 2020 arritën nivelin 1.87 përqind duke shënuar kështu rritje mujore prej 0.10 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 0.62 pikë përqindje.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë


4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshem i pagesave për tremujorin e katërt të vitit 2019 rezultoi negativ në rënie të mjeteve të rezervës, prej rreth 73 milionë euro. Tremujori i katërt i 2019-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 346 milionë euro ngushtuar në terma vjetorë me rreth 26 milionë euro (ose 7%). Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 320 milionë euro, në rënie me 10 milionë euro referuar nivelit në një vit më parë. Flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) shënuan 103 milionë euro nga 586 milionë euro të regjistruara në të njëjtën periudhë në 2018 përfshirë këtu emetimin e eurobondit të qeverisë.

Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.


Gjatë periudhës, vëllimi i transaksioneve korrente shënon 3,193 milionë euro, zgjeruar në terma vjetorë me rreth 6%. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në 346 milionë euro, rreth 7% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Ecuria e deficitit korrent ka reflektuar zgjerimin e balancave pozitive në shërbime dhe të ardhura dytësore. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për tremujorin e katërt të 2019 (Fig-6):

- (i) bilanci tregtar me -842.9 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 273.0 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -48.9 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 272.3 milionë euro.



Bilanci i Pagesave per T4 - 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë



Llogaria Korente per T4 - 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë



5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Shkurt 2020, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 8.402 milionë lekë krahasuar me muajin Shkurt të vitit 2019. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankës paradepozituese me 12.192 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 1.357 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 3.515 milionë lekë e bankës qendrore.


Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.330.924 milionë lekë në muajin Shkurt 2020, duke shënuar rritje prej rreth 52.322 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 4.1 përqind.

Gjithashtu në muajin Shkurt 2020, sistemi bankar rezulton me rritje mujore prej 6.591 milionë lekë ose 0.5 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.




6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Shkurt 2020 arriti në rreth 578.622 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 37.075 milionë lekë, ose rritje me rreth 6.85 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (52.1%) dhe monedhave të huaja (47.9%).



Gjatë muajit Shkurt 2020, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 59.0 përqind ose 341.303 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.31 përqind ose 198.522 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.24 dhe 2.37 përqind apo 24.549 dhe 13.707 milionë lekë.




Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Shkurt 2020, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 71.7 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.2 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.1 përqind dhe rreth 1.99 përqind.

7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 289.080 milionë lekë në fund të muajit Shkurt 2020. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Shkurt 2020 ka shënuar rritje mujore prej 0.08 përqind, si dhe rritje vjetore prej 0.39 për qind, duke arritur nivelin 21.7 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rritje mujore prej 0.13 përqind si dhe rritje vjetore prej 0.63 përqind, duke shënuar nivelin 27.7 përqind.


Fig-11



Raportet të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat
Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Shkurt 2020, kanë shënuar rritje vjetore prej 23.058 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 80.3 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Shkurt 2020 shënuan rritje prej 12.946 milionë lekë në krahasim me muajin Shkurt 2019. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 82.0 përqind të tyre.

Fig-12





Raporti i Depozitave ndaj M3
Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Shkurt 2020, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 82.0 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 13.1 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.8 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 80.3 përqind dhe rreth 16.9 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 81.1 përqind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 844.818 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (157.940 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (19.444 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (17.928 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.711 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Shkurt 2020, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.041.843 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 4.118 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 36.005 milionë lekë.




Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Shkurt 2020 janë mbledhur rreth 71.236 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 67.504 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 64.873 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 2.632 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 36% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 46.931 miliardë lekë (ose rreth 103% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 2.943 miliardë lekë (ose rreth 92% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 17.104 miliardë lekë (ose rreth 102% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jotatimore në nivelin 3.471 miliardë lekë (ose rreth 103% e planit për periudhën Janar - Shkurt 2020).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 64.873 miliardë lekë, 12.427 miliardë lekë (19% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 6.487 miliardë



lekë (10%) për shpenzime interesi, 6.063 miliardë leke (9%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 126 miliardë lekë (0.2%) për subvencione, 27.153 miliardë lekë (42%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 6.841 miliardë lekë (11%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 5.077 miliardë lekë (8%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 15% (shpenzime personeli), 16% (shpenzime për interesat), 12% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 10% (subvencione), 15% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 12% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 21% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 1%, ndërsa financimi i huaj është 6% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Shkurt 2020 ishin rreth 71.236 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 66.979 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 3.471 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Shkurt 2020 (mld Lekë) Revenues during February 2020 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Shkurt '20 February '20	Shkurt '19 February '19	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	11.43	10.57	8.10
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.50	0.43	17.0
	Akcizat (Excise)	3.35	3.12	7.3
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	2.25	2.43	-7.6
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	2.64	2.91	-9.2
	Taksat nacionale (National Tax)	2.98	2.64	12.7

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Shkurt - 2020

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: February - 2020

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 3.7 miliardë lekë gjatë periudhës Janar - Shkurt 2020, u përdor kryesisht për huamarrjen e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe për huanë afatgjatë të huaj.

Për muajin Shkurt 2020, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 35.224 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 34.990 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Shkurt 2020, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 32.6 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë muaj, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 32.9 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 2.0 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1																
Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019	2020	2016	2017	2018	2019	2020	
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4	1.0	1.0	1.1	1.1	1.1	0.2	2.2	2.1	1.7	1.2	February
Mars	0.5	0.4	0.3	-0.3		0.8	0.8	0.9	0.6		0.3	2.1	2.0	1.1		March
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2		0.5	0.5	0.5	0.4		0.3	1.9	2.1	1.4		April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0		0.2	0.1	0.2	0.1		0.7	2.0	2.1	1.5		May
Qershor	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3		0.04	0.0	0.1	0.1		1.2	2.2	2.4	1.3		June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1		0.04	0.0	0.1	0.0		1.9	2.0	2.3	1.5		July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3		0.14	0.1	0.1	0.1		2.0	1.6	2.2	1.5		August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1		0.17	0.1	0.1	0.1		1.8	1.6	2.1	1.3		September
Tetor	-0.2	0.0	-0.2	-0.2		0.13	0.1	0.1	0.0		1.5	1.9	1.9	1.3		October
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2		0.12	0.1	0.1	0.0		1.9	1.7	1.8	1.4		November
Dhjetor	0.9	1.0	1.1	0.8		0.19	0.2	0.2	0.1		2.2	1.8	1.8	1.2		December

Burimi: INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019	2020		Currency
						Janar	Shkurt	
						January	February	
<i>Mesatarja e periudhës</i>								<i>Average of period</i>
USD	126.64	128.29	112.56	108.43	109.94	110.06	111.94	USD
EURO	137.65	135.27	133.25	123.45	122.17	122.08	122.13	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>								<i>In the end of period</i>
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.64	110.71	111.38	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	121.77	122.13	122.74	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020		
Në përqindje						Janar January	Shkurt February	In percent
Norma e depozitave								Deposits rates
12-M	1.27	0.78	0.80	0.75	0.43	0.40	0.42	12-M
6-M	1.17	0.78	0.56	0.56	0.41	0.48	0.27	6-M
3-M	0.54	0.27	0.29	0.30	0.17	0.40	0.14	3-M
1-M	0.88	0.87	0.82	0.62	0.72	0.81	0.76	1-M
Norma e huasë								Lending rates
12-M	7.47	4.54	6.79	6.34	6.82	6.73	6.26	12-M
6-M	8.35	7.01	8.12	8.16	6.34	6.87	6.78	6-M
Norma e letrave me vlerë								Securities rates
Bono thesari 1/								Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	-	-	-	1.29	3-M
6-M	2.46	2.00	-	-	-	1.50	-	6-M
12-M	2.40	2.92	2.63	1.43	1.69	1.77	1.87	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2020

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2020

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	Janar January	Shkurt February	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	36,012	71,236	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	204	785	Grants
II.	Të ardhura tatimore	34,315	66,979	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	23,535	46,931	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	11,493	22,929	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	2,255	4,506	Profit Tax
3	Akcizat	3,399	6,750	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,459	6,109	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	2,478	5,682	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	451	955	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,229	2,943	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	265	576	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	7	16	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	957	2,352	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	9,551	17,105	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	8,205	14,780	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,339	2,324	Health insurance
III.	Të ardhura Jotatimore	1,492	3,471	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë			Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	986	2,276	Income of budgetary institutions
	TOTALI I SHPENZIMEVE	32,514	67,504	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	31,948	64,873	Current Expenditures
I.1	Personeli	6,184	12,427	Personnel expenditures
1	Paga	5,301	10,649	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	877	1,753	Social insurance contributions
I.2	Interesat	4,289	6,487	Interest
1	Të Brendshme	3,123	4,766	Domestic
2	Të Huaja	1,165	1,721	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,431	6,063	Operational & Maintenance
I.4	Subvencionet	64	126	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	13,486	27,852	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	10,290	20,441	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,715	6,712	Health insurance
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,499	6,841	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	2,995	5,077	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	43	87	Unemployment insurance benefits
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca		0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	566	2,632	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	-1	646	Domestically financing
2	Financimi Huaj	568	1,901	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetuara			Arrears
V.	DEFICITI	3,498	3,731	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-3,498	-3,731	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-2,419	-1,737	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	2	23	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	5,408	8,635	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-7,829	-10,394	Others
V.3	I huaj	-1,078	-1,995	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	364	1,565	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	184	364	Subsidiary Loan
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	6	-441	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,448	-3,119	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore		0	Budgetary Support

Tab - 5

Tabela e investimeve 2020

Table of investments 2020

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	
Financim i brendshëm	- 2,419	- 1,737	Domestic financing
<i>Në %</i>	23.6	46.54	<i>In %</i>
Financim i huaj	- 7,829	- 1,995	Foreign financing
<i>Në %</i>	76.4	53.46	<i>In %</i>
Totali	-10,248	-3,731	Total
<i>Në %</i>	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2020
CUSTOMS REVENUES 2020**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	
Taksë doganore	451	955	Customs Duties
TVSH	7,434	15,763	V.A.T
Akcizë	3,399	6,750	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	246	465	Others (Mineral Rent)
TOTALI	11,530	23,933	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2020 (TAX REVENUE)

TVSH	4,059	7,166	V.A.T
Tatim mbi fitimin	2,255	4,506	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,459	6,109	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	2,232	5,217	National taxes
TOTALI	12,006	22,997	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	23,535	46,931	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2020

The Deficit and Its Financing for 2020

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million ALL)

	Janar January	Shkurt February	
TË ARDHURAT	36,012	71,236	REVENUE
SHPENZIMET	32,514	67,504	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	3,498	3,731	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-3,498	-3,731	FINANCING
Financimi i brendshëm	-2,419	-1,737	Domestic
a. Bono Thesari Neto	1,501	3,103	Treasury bills
b. Obligacione	3,921	5,559	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	5,162	5,025	Chang. of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	5,485	6,866	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	-323	-1,841	Deposit of Social & Health Ins.
d. Mjete në ruajtje	-49	-114	Non-budget revenues
e. Të ardhura nga privatizimi	2	29	Privatization receipts
f. Të tjera detyrime	-12,939	-15,256	Others
g. Huamarrje Brendshme Vendori	-15	-19	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	-1,078	-1,995	Foreing
a. Hua afatgjatë	364	1,565	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	6	-441	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,448	-3,119	Repayments
d. Mbeshtetje Buxhetore	0	0	Budgetary Support
Burimi: Ministria e Financave			Source: Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	3M_I_2019	3M_II_2019	3M_III_2019	3M_IV_2019	Viti 2019	
Llogaria korente	-811.60	-865.60	-862.90	-247.80	-283.00	-163.70	-346.40	-1,041.20	Current Account.
Bilanci tregtar	-2,602.80	-2,824.10	-2,871.00	-694.50	-781.60	-824.60	-842.90	-3,143.60	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	713.70	797.10	986.10	209.50	242.20	226.00	229.00	906.60	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,316.50	-3,621.20	-3,857.10	-904.00	-1,023.80	-1,050.60	-1,071.90	-4,050.20	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	796.60	1,081.90	1,104.00	290.70	262.70	447.70	273.00	1,274.00	Services Balance.
Shërbimet Kredi	2,395.70	2,856.20	3,065.80	675.70	816.10	1,119.00	787.70	3,398.20	Services Credit
Shërbimet Debi	1,599.10	1,774.30	1,961.80	385.00	553.40	671.30	514.70	2,124.20	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	174.10	28.90	-8.60	-35.20	-12.60	-42.90	-48.80	-139.70	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	408.70	407.70	398.00	76.00	129.70	106.00	108.20	419.80	Income Credit
Të ardhurat Debi	-234.60	-378.80	-406.60	-111.20	-142.30	-148.90	-157.00	-559.50	Income Debt
Bilanci i transfertave	820.50	847.70	912.70	191.20	248.50	256.10	272.30	968.10	Balance of Transfers
Transferta private	961.20	961.80	1,002.90	220.10	274.20	280.80	298.40	1,073.50	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	-140.70	-114.10	-90.20	-28.90	-25.70	-24.70	-26.10	-105.40	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	66.20	122.30	104.00	17.90	12.30	19.70	26.20	76.10	Capital Account
Llogaria financiare	-664.30	-1,115.30	-1,145.40	-305.00	-301.10	-128.70	-76.80	-819.80	Financial Account
Investime direkte	-936.50	-993.80	-1,026.00	-287.20	-227.50	-266.30	-250.00	-1,031.20	Direct Investment
Investime portofoli	225.20	-100.00	-75.10	-0.20	-82.40	93.40	129.80	140.60	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	187.40	49.00	-50.40	-17.90	4.00	39.40	35.50	53.00	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	128.90	-186.30	-18.20	-143.80	-84.60	125.20	170.40	67.70	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	47.80	185.70	368.30	-68.70	-54.20	109.90	-73.00	-77.60	Overall Balance
Rezervat	47.70	185.40	371.50	-70.70	-43.60	109.70	-73.00	-77.70	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	140.40	70.50	-6.10	-0.30	-4.80	-4.80	-7.90	-17.80	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhes	2016	2017	2018	2019	2020		Millions of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	
Mjetet valutore neto	389,612.7	390,687.6	412,444.5	402,015.9	399,267.3	402,782.7	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	418,562.1	417,605.4	436,487.8	426,984.7	423,459.0	427,650.5	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidënteve	28,949.4	26,917.8	24,043.3	24,968.8	24,191.7	24,867.8	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	65,915.7	59,998	21,779	44,589	42,832	44,354	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	34,255.6	18,407	-12,366	8,490	14,820	15,118	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	53,279.9	52,839.5	55,628.9	55,206.3	55,414.6	55,998.2	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	19,024.3	34,432.8	67,994.8	46,715.9	40,595.1	40,880.7	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	29,934.4	39,871.3	32,317.6	33,956.4	25,877.4	27,108.1	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,725.7	1,720.0	1,827.2	2,141.8	2,135.6	2,128.6	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	414,380.9	452,243.1	423,427.9	433,951.2	425,982.3	428,401.0	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	194.0	146.6	80.6	72.6	75.0	76.5	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	47.2	96.8	285.4	229.5	192.0	241.8	Other accounts payable
Të tjera neto	-20,953.6	-20,683	-20,659	-20,775	-21,185	-21,209	Other items net
Aksione	61,859.9	45,882.2	31,088.6	33,126.1	37,035.9	39,626.2	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 **KREDIA PËR EKONOMINË**
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020		Million of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	
Totali i kredisë	547,602.4	550,280.4	532,628.2	570,553.0	569,030.3	578,622.0	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	845.5	787.7	539.0	560.6	548.4	541.6	Credits to local Government
Në lekë	845.5	787.7	539.0	560.6	548.4	541.6	in Lek
Në valutë	-	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	26,863.9	29,515.4	20,270.1	24,182.4	24,452.2	24,548.8	Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	23,993.9	24,453.5	16,594.2	18,489.7	18,911.4	19,016.3	in Lek
Në valutë	2,870.0	5,061.9	3,675.9	5,692.7	5,540.8	5,532.5	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	343,483.0	334,762.9	317,722.0	335,884.6	333,540.0	341,303.0	Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	131,743.5	136,075.7	127,999.7	141,240.5	138,603.2	142,452.2	in Lek
Në valutë	211,739.5	198,687.2	189,722.3	194,644.1	194,936.8	198,850.8	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	8,687.6	7,944.6	10,164.0	13,555.1	13,533	13,707	Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	4,242.3	3,522.3	4,802.1	8,023.8	7,837	7,878	in Lek
Në valute	4,445.3	4,422.3	5,361.9	5,531.3	5,696.2	5,828.8	in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	167,722.4	177,269.8	183,933.1	196,370.3	196,956.5	198,521.8	Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	98,722.3	108,419.1	118,744.1	130,170.0	130,778.4	131,415.3	in Lek
Në valutë	69,000.1	68,850.7	65,189.0	66,200.3	66,178.1	67,106.5	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

OFERTA E PARASË
 Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020		Millions of LEK End of Period
					Janar January	Shkurt February	
Baza monetare	414,380.9	425,243.1	423,427.9	433,951.2	425,982.3	428,401.0	Base Money
Ndryshimi vjetor në %	7.9	2.6	-0.4	1.0	1.0	1.0	Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave depozituese	249,256.5	265,156.0	275,281.4	291,409.0	286,606.8	289,080.3	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	4.2	6.4	3.8	5.9	5.5	6.0	Y/Y change in %
Depozita	737,808	741,157	745,304	791,041	801,527.9	805,289.8	Deposits
Ndryshimi vjetor në %	7.3	0.5	0.6	6.1	6.0	6.4	Y/Y change in %
Agregati M1	435,432.3	461,550.1	478,717.6	523,968.3	522,908.1	528,920.4	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	13.4	6.0	3.7	9.5	8.7	9.3	Y/Y change in %
Agregati M2	736,944.1	738,900.0	731,352.3	758,021.7	756,567.1	762,539.4	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	1.9	0.3	-1.0	3.6	3.3	4.0	Y/Y change in %
Agregati M3	1,263,453.8	1,266,906.9	1,263,928.1	1,318,662.0	1,324,332.3	1,330,924.1	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	3.9	0.3	-0.2	4.3	3.9	4.1	Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare							Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	389,612.7	390,687.6	412,444.5	402,015.9	399,267.3	402,782.7	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	65,915.7	59,998.0	21,779.0	44,588.6	42,832.4	44,354.3	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	34,255.6	18,406.7	-12,365.8	8,490.4	14,819.5	15,117.5	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	29,934.4	39,871.3	32,317.6	33,956.4	25,877.4	27,108.1	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020		Millions of Leks End of Period
					Janar January	Shkurt February	
Në lekë	487,687	473,744	456,071	466,382	469,960	473,459	In national currency
Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë (D. p)	186,176	196,394	203,436	232,559	236,301	239,840	Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	1,907.5	1,344.4	1,482.1	1,624.5	1,472.6	1,569.4	Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,786.0	8,656.7	8,861.1	10,786.4	11,223.7	11,877.3	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	2,071.0	2,524.8	2,586.8	3,780.6	3,766.8	4,176.9	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	46,051.0	48,979.3	49,221.4	51,972.3	53,900.1	53,152.6	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	129,360.4	134,889.0	141,284.9	164,395.5	165,938.1	169,064.0	Other resident sectors
Depozita të tjera	301,512	277,350	252,635	233,823	233,658	233,619	Other deposits
Qeveria lokale	18.9	15.2	13.1	10.1	10.1	10.1	Local governments
Korporata jofinanciare publike	976.8	705.2	1,634.7	709.2	627.9	1,484.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	7,553.4	9,282.1	5,050.5	4,146.7	3,922.6	3,909.4	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	6,502.2	9,062.4	9,687.0	7,977.5	8,705.0	8,821.5	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	286,460.2	258,285.1	236,249.4	220,979.3	220,392.8	219,393.8	Other resident sectors
Në valutë	250,121	267,413	289,233	324,659	331,568	331,831	In foreign currency
Qeveria lokale	366.1	139.8	113.4	157.9	107.4	132.4	Local governments
Korporata jofinanciare publike	2,999.4	2,086.3	1,407.7	2,823.3	2,785.9	2,773.8	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,815.4	3,756.9	3,616.6	5,360.3	5,662.3	4,932.1	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	73,325.0	74,187.3	78,055.3	81,786.9	83,945.3	84,592.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	171,614.8	187,242.7	206,039.8	234,530.3	239,067.3	239,400.3	Other resident sectors
Totali	737,808	741,157	745,304	791,041	801,528	805,290	Total
Qeveria lokale	2,292.5	1,499.4	1,608.6	1,792.5	1,590.1	1,711.9	Local governments
Korporata jofinanciare publike	10,762.2	11,448.2	11,903.5	14,318.9	14,637.5	16,135.3	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	11,439.8	15,563.8	11,253.9	13,287.6	13,351.7	13,018.4	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	125,878.2	132,229.0	136,963.7	141,736.7	146,550.4	146,566.1	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	587,435.4	580,416.8	583,574.1	619,905.1	625,398.2	627,858.1	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

Tab - 13 **BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH**
Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2016	2017	2018	2019	2020		Millions of Lek End of period
					Janar January	Shkurt February	
AKTIVET	524,731	532,927	547,104	539,622	528,261	534,274	
Total	131,887	187,367	209,596	176,674	169,607	167,539	Total
Mbajjet e SDR	27,211.8	25,725.3	19,625.0	24,187.9	25,173.3	24,919.7	SDR holdings
Arka në valutë	52.0	24.3	67.1	98.3	53.0	35.6	Foreign currency
Depozitat	104,622.9	161,617.3	189,904.2	152,387.6	144,381.0	142,583.6	Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	315,113	259,538	261,577	283,679	288,186	294,504	Securities other than shares
Jorezident	261,877.5	206,818.9	205,990.4	228,514.0	232,812.9	238,547.4	nonresidents
Qeveria qendrore	53,235.2	52,718.8	55,586.8	55,164.9	55,373.2	55,956.9	central government
Huatë	31,660	41,591	34,145	36,098	28,012	29,236	Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	29,934.4	39,871.3	32,317.6	33,956.4	25,877.4	27,108.1	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,725.9	1,719.8	1,827.1	2,141.4	2,134.7	2,127.5	Other resident secotrs
Derivatet financiare	15.8	11.7	19.3	13.8	25.3	31.9	Financial derivatives
Llogari të arketueshme	25,094.1	23,844.9	21,224.9	22,325.3	21,573.6	22,078.1	Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	20,961.2	20,574.7	20,542.0	20,832.0	20,856.9	20,885.3	Nonfinancial assets
DETYRIMET	524,731	532,927	547,104	539,622	528,261	534,274	LIABILITIES
Total	262,031	278,611	286,209	303,195	297,287	299,611	Total
Para në qarkullim	258,848.0	274,711.8	286,158.4	303,092.6	297,238.9	299,550.9	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	3,183.2	3,899.2	50.6	102.2	48.4	59.6	Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	191,380	200,514	222,292	194,623	186,416	186,816	Deposits excluded from broad money
Jorezident	19,860.9	19,350.9	17,047.3	17,108.5	17,102.3	17,102.2	Nonresidents
Qeveria qendrore	18,975.1	34,384.3	67,945.2	46,685.3	40,543.6	40,846.6	Central government
Korporata të tjera depozituese	152,349.7	146,632.1	137,218.8	130,756.4	128,695.0	128,790.6	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	72.1	66.7	49.6	52.5	54.9	56.4	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	121.9	79.9	31.0	20.1	20.1	20.1	
Huatë	314	116	18	0	0	0	-
Jorezidentët	314.2	115.6	18.3	-	-	-	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
Llogari të pagueshme	1,164.6	463.8	518.7	1,690.8	432.6	1,131.5	Other accounts payable
Alokimi i SDR	7,981.2	7,340.5	6,977.7	6,987.3	7,089.4	7,090.1	SDR allocation
Aksione dhe instrumenta të tjerë	61,859.9	45,882.2	31,088.6	33,126.1	37,035.9	39,626.2	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania